



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravlja / Ministry of Health  
Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale / Kosovska Agencija za Proizvoda / Kosovo Medicines Agency  
Njësi: 01  
Nr. i llogaritjes: 15 -  
Data: 05/12/2025

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravlja / Ministry of Health  
Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale / Kosovska Agencija za Proizvoda / Kosovo Medicines Agency  
Nr. i llogaritjes: 01  
Nr. i faqeve: 15 -  
Br. stranke: -15 -  
No. pages: -15 -  
Prishtinë / a

|                       |                                                                                                                                            |
|-----------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| DATA/DATE             | 05.12.2025                                                                                                                                 |
| PËR/ZA/TO             | Dr.Arsim Berisha- Zëvendësminister i Shëndetësisë                                                                                          |
| PËRMES/PREKO/THROUGH  | Znj. Zana Haraqija -Kryesuese ekipit punues për menaxhimin e procesit të mbikëqyrjes së performancës së AKPPM-së                           |
| NGA/FROM              | Arian Ahmeti - UD. Krzeshef Ekzekutiv – AKPPM-së                                                                                           |
| Cc./Cc/cc             | Zt. Jahë Gecaj - UD Sekretar i Përgjithshëm në MSH<br>Sevdije Rushiti- Zyrtare përgjegjëse për hartimin e planit të Performancës për AKPPM |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Plani i Performancës së AKPPM-së për vitin 2026                                                                                            |

I nderuar Zëvendësminister i Shëndetësisë,

Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale/AKPPM ka pregaditur Planin e Performancës 2026 sipas Rregullores(QRK) Nr.12/2023, ku së bashku me ekipin përgjegjës pas një pune intezive për hartimin e planit të Performancës për AKPPM, kemi arritur të finalizojmë dhe të aprovohet nga të dy palët.

Ju lutem gjeni:

Plani i Performancës së AKPPM-së për vitin 2026

Me respekt,



Agjencia e Kosovës për produkte dhe Pajisje Medicinale  
Kosova Medicines Agency  
Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstava

*Plani i Performancës së Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale*

Prishtinë, 2026

## **Përmbajtja**

|                                                                                                                       |       |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| Lista e shkurtesave.....                                                                                              | 3     |
| A.Pjesa përshkruese e Planit të Performances së Agjencisë.....                                                        | 4     |
| Përmbledhja Ekzekutive .....                                                                                          | 4     |
| Hyrje .....                                                                                                           | 6     |
| Objektivat, treguesit e performances dhe aktivitetet.....                                                             | 7     |
| Buxheti ,kufijtë buxhetor,planifikimi i të hyrave vetanake si dhe informatat dhe udhezimet në qarkoret buxhetore..... | 9     |
| B.Pjesa tabelare .....                                                                                                | 10-11 |

AKPPM-Agjencia e Kosoves për Produkte dhe Paisje Medicinale  
 MSH-Ministria e Shëndetësisë  
 QRK-Qeveria e Republikës së Kosovës  
 ZKM-Zyra e Kryeministrit  
 SKQ-Sekretariati Koordinues i Qeverisë  
 DAM-Autorizim Marketingu  
 DABF-Departamenti i Administratës, Buxhetit dhe Financave  
 DL-Departamenti i Licencimit  
 PhV- Departamenti i Farmakovigjilences  
 KASH-Korniza Afatmesme e Shpenzimeve  
 UA- Udhezimi Administrativ  
 OB-Organizata Buxhetore  
 QB-Qarkorja Buxhetore  
 OE-Operatori Ekonomik  
 ZKA-Zyrtari Kryesor Administrativ  
 ZKF-Zyrtari Kryesor Financiar  
 PVPQ-Plani Vjetor i Prioriteteve të Qeverisë  
 OM5H-Objektivat e Ministrisë së Shëndetësisë  
 GP-Grupi punues  
 PP-Plani i Performances  
 DAE-Drejtori i Agjencisë Ekzekutive  
 NJPMP-Njesia Përgjegjëse për Menaxhimin e Performances  
 RP-Raporti i Performances  
 DPVA-Deklarata e Performances Vjetore të Agjencisë  
 PPPP-Pjesa Përkrahëse e Planit të Performances  
 PTPP-Pjesa Tabelare e Planit të Performances  
 RP-Rishikimi i Planit  
 DPP-Draft Plani i Performances  
 KB-Konsultimi i Brendshëm  
 MP-Miratimi i planit  
 PP-Publikimi i planit

## **A. Pjesa Përshkruese e Planit të Performances së AKPPM-së**

### **Përmbledhje Ekzekutive**

Plani i performancës i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale përfshin periudhën kohore një vjeqare. Ky plan përfshin një përmbledhje ekzekutive të objektivave, treguesve dhe aktiviteteve të AKPPM-së për vitin kalendarak 2026.

Hartimi i këtij dokumenti të rëndësishëm për Agjencinë është bazuar në Rregulloren (QRK) NR.12/2023 Mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë kuadër Administrates Shtetërore. Gjatë vendosjes së objektivave është marrë parasysh përmbushja e standardeve të kërkuara si në vijim:

1.1. Objektivat e AKPPM-së të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të afatizuara;

1.2. Objektivat do të adresojnë problemet dhe shkaqet e tyre të cilat janë hasur gjatë punës për zbatimin e mandatit të Agjencisë;

1.3. Objektivat do të jenë në pajtim me prioritetet dhe objektivat afatmesme të Ministrisë së Shëndetësisë, përkatësisht Zyres së Kryeministrit dhe të Qeverisë të harmonizuara me PVPQ;

1.4. Objektivat do të synojnë zbatimin e mandatit të Agjencisë dhe janë të ndërlidhura njëra me tjetrën;

1.5. Plani do të përmbajë jo më pak se 3 dhe jo më shumë se 5 objektiva.

Objektiva e I-të Sigurimi i cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit të barnave, është përcaktuar duke pasë parasysh misionin e AKPPM-së që ka të bëjë me mbrojtjen e shëndetit publik përmes garantimit të cilësisë, efikasitetit dhe kontrollit të produkteve dhe pajisjeve medicinale.

AKPPM përmes departamenteve profesionale si: Laboratori i Kontrollit të Cilësisë, Farmakovigjilencës, Autorizim Marketingu, Licencimi, mbikqyrë cilësinë e të gjitha produkteve medicinale që gjenden në tregun e Republikës së Kosovës.

AKPPM ka bashkëpunim të ngushtë me institucione tjera si policia, dogana e Kosovës dhe institucionet tjera relevante.

Objektiva e II-të të është vendosur bazuar në nevojën e zhvillimit dhe efikasitetit të mëtejshëm të sistemit elektronik “Barnatari”. i cili iu ofron palëve të interesit kryerjen e shërbimeve të ofruara nga AKPPM-ja online (në distancë). Ky projekt është vlerësuar nga ekspertet e fushës së teknologjisë informative si projekt i mirë i mirë në ofrimin e shërbimeve publike dhe ka lehtësuar dukshëm punën si në Agjenci e poashtu edhe të palëve të interesit.

Objektivi i III-të bazohet me marrjen e informatave/njoftimeve paraprake nga agjencitë ndërkombtare (EMA, OBSH ), LKC, IKSHP dhe laboratorët referente lidhur me efekte anësore të produkteve medicinale.

Përmes këtyre informata/njoftimeve, departamenti i farmakovigjilencës PHV rekomandon, njofton të gjitha institucione farmaceutike dhe shëndetësore ndalimin e përdorimit dhe tërheqjen nga tregu të produktit medicinal me efekte anësore.

Objektivi i IV-të përmes këtij objektiivi synohet, që të rritet niveli i llogaridhënies dhe transparencës ndaj publikut dhe të mundesoj pjesëmarrjen e informuar të qytetarëve në procesin e punës së agjensisë.

Përcaktimi i treguesve të performancës, aktivitetëve është bërë për të qartësuar rezultatet specifike që Agjencia synon të arrijë.

Sa i përket burimeve njerëzore dhe burimeve financiare, AKPPM do të bazohet në resurset aktuale dhe në ato që janë të planifikuara me Ligjin e Buxhetit.

## Hyrje

Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale dhe Pajisje Medicinale është autoritet kompetent i Republikës së Kosovës përkitazi me produktet dhe pajisjet medicinale për përdorim njerëzor.

AKPPM është organ i pavarur ekzekutiv i Ministrisë së Shëndetësisë me subjektivitet juridik, që ka përgjegjësi ligjore përkitazi me çështjet shkencore dhe teknike që kanë të bëjë me produktet dhe pajisjet medicinale për përdorim njerëzor.

Agjencia ka për qëllim që të përcaktojë rregullat dhe procedurat për prodhimin, kontrollin e cilësisë, klasifikimin, autorizimin për marketing, regjistrimin, importin, tregtinë, farmakovigjilencën, hulumtimet klinike, mbikëqyrjen e produkteve medicinale dhe pajisjeve medicinale në Republikën e Kosovës në mënyrë që qytetarët të kenë produkte medicinale të sigurta, efektive dhe kualitative.

Organizimi, autorizimet, dhe fushëveprimi i organeve të AKPPM, përcaktohen me akt nën-ligjor të miratuar nga Qeveria.

Plani i performancës së AKPPM-së bazën ligjore e ka në pajtim me nenin 30, paragrafi 8 të Ligjit Nr.06/1-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura si dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.12/2023 Mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë kuadër Administrates Shtetërore.

Qëllimi kryesor i këtij plani të performancës është përcaktimi i objektivave, treguesve të performances dhe aktiviteteve që Agjencia synon t'i realizojë brenda një viti.

Plani i performances është i nderlidhur me mandatin e Agjencisë, fushëveprimi i të cilit është caktuar me Ligjin Nr.04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

Si metodologji e hartimit të këtij plani grupi punues ka shfrytëzuar mbledhjen e të dhënave zyrtare të AKPPM-së, Ministrisë së Shëndetësisë, Qeverisë së Kosovës dhe është në harmoni të plotë me politikat-prioritetet Qeveritare.

Ky plan mund të ketë rreziqe dhe vështirësi në zbatimin e tij pasi që nuk varet nga AKPPM aprovimi i kërkesave për planin legjislativ të MSH-së meqë AKPPM është institucion vartës i MSH-së.

## **Objektivat, treguesit e performancës dhe aktivitetet**

Grupi punues duke respektuar standardet e kërkuara gjatë hartimit të planit të performances është percaktuar në katër (4) objektiva kryesore për vitin kalendarik 2026.

**Objektiva e I-të:** Sigurimi i cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit të barnave

Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë për produkte dhe pajisje medicinale në tregun e Republikës së Kosovës

Përmes kësaj objektive AKPPM synon mbikqyrjen e produkteve medicinale dhe pajisjeve medicinale në Republikën e Kosovës në mënyrë që qytetarët të kenë produkte dhe pajisje medicinale të sigurta, efektive dhe kualitative.

Treguesit të performancës lidhur me progresin për arritjen e objektivës së parë janë:

- Rritja e numrit të analizave të cilësisë,
- Rritja e numrit të raportimit të efekteve anësore

Aktivitetet që do të realizojë AKPPM në funksion të përmbushjes së objektivës së I-të

Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë për produkte dhe pajisje medicinale në tregun e Republikës së Kosovës

- Pranimi i mostrave dhe raportimi final i testimeve për produktet medicinale të pranuar nga inspektorati farmaceutikë.
- Pranimi i mostrave dhe raportimi final i testimeve sipas programit të rregullt të mostrimi.
- Informimi dhe raportimi i efekteve anësore,
- Auditimi i praktikës së mirë të prodhimit të produkteve që posedojnë certifikatën e AM-së në Republikën e Kosovës,
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me policinë dhe doganën për mbrojtjen e tregut nga produktet medicinale të paligjshme dhe të falsifikuara.

## **Objektiva e II-të: Zhvillimi i modulit për pajisje medicinale në sistemin e Barnatarit**

Përmes këtij objektivit synohet implementimi i modulit të Pajisjeve. Duke pasur parasysh numrin shumë të madhë të pajisjeve që aplikojnë për import, një regjister me emertimin e pajisjeve do të përshpëjtonte procedurat e evaluimit të aplikimeve për import të pajisjeve medicinale si dhe digitalizimi i modulit të pajisjeve që e bënë lehtësimin e shërbimeve në kuadër të departamentit të Licencimit.

- Evidentimi i pajisjeve që importohen
- Numri i pajisjeve të regjistruara
- Numri i pajisjeve të aplikuara online/në mënyrën digjitale

Aktivitetet që do të realizojë AKPPM në funksion të përmbushjes së objektivës së II-rë për Krijimi i modulit për pajisje medicinale në sistemin e Barnatarit janë:

- ✓ Rregullimi i bazës ligjore për pajisjeve medicinale;
- ✓ Grumbullimi i informatave lidhur me llojin e pajisjeve medicinale të vendosura në treg 5 vitet e fundit;
- ✓ Identifikimi i të dhënave esenciale për pajisjet medicinale, të cilat do të inkorporohen në modul që mundësojnë rritjen e efikasitetit të mbikëqyrjes;
- ✓ Shqyrtimi me operatorin ekonomik lidhur me mundësinë e inkorporimit të të dhënave në sistemin 'Barnatari';
- ✓ Krijimi i modulit fillestar;
- ✓ Testimi tremujor me qarkulluesit farmaceutik të selektuar;
- ✓ Finalizimi i modulit;
- ✓ Trajnimi i stafit dhe të qarkulluesve farmaceutik me shumicë për përdorimin e modulit.

### **Objektiva III-të: Raportimi i efekteve anësore dhe njoftimi i profesionistëve shëndetësor, pacientëve dhe publikut të gjerë**

Përmes kësaj objektivë synohet që AKPPM-ja të informojë/njoftojë opinionin publikë lidhur me efektet anësore të produkteve medicinale. Tregues të performancës lidhur me progresin për arritjen e objektivës së III-të janë:

- Raportimi i efekteve anësore
- Informimi i opinionit publikë lidhur me efektet anësore të produktit medicinal.

Aktivitetet që do të realizojë AKPPM në funksion të përmbushjes së objektivës së IV-të janë:

- Njoftimi i subjekteve farmaceutike dhe institucionet shëndetësore lidhur me efektet anësore të produktit medicinal
- Kërkon tërheqjen nga tregu të produktit medicinal me efekte anësore
- Mban kontakte dhe kërkon raporte nga personat e autorizuar për farmakovigjilencë të subjekteve farmaceutike që kanë produkte të regjistruara në AKPPM.

### **Objektiva IV-të: Transparenca dhe komunikimi me publikun**

Përmes kësaj objektivë synohet që AKPPM-ja të informojë/njoftojë opinionin publikë lidhur me efektet anësore të produkteve medicinale.

Tregues të performancës lidhur me progresin për arritjen e objektivës së IV-të janë: Publikimi i Informacionit në ueb faqen e AKPPM-së

- Raportimi i efekteve anësore
- Informimi i opinionit publikë lidhur me efektet anësore të produktit medicinal.

Aktivitetet që do të realizojë AKPPM në funksion të përmbushjes së objektivës së IV-të janë:

- Publikimi i Akteve dhe Vendimeve
- Transparenca financiare/Buxhetore
- Publikimi i Listave të produkteve të regjistruara në DAM
- Publikimi i listës së veprimtarive qarkulluese me pakice dhe shumice
- Publikimi i produkteve orfane
- Adresimi i Kërkesave / Akesave

**Buxheti, kufijtë buxhetor, planifikimi i të hyrave vetanake si dhe informatat dhe udhëzimet në qarkoret buxhetore**

| <b>Organizata Buxhetore dhe Kodi organizativ</b> |  | <b>206 – Ministria e Shëndetësisë</b>     |
|--------------------------------------------------|--|-------------------------------------------|
| Nën-programi                                     |  | 72000 – Rregullimi i Sektorit Farmaceutik |
| Shpenzimet e planifikuara- Gjithsej              |  | 1,672, 912.37€                            |
| Të punësuarit për vitin 2026                     |  | 48                                        |
| Paga dhe mëditje                                 |  | 518,502.00€                               |
| Mallra dhe shërbime                              |  | 542,675.00€                               |
| Komunalitë                                       |  | 12,000.00€                                |
| Kapitale                                         |  | 744,000.00€                               |
| <b>Planifikimi i të hyrave për vitet 2025</b>    |  |                                           |
| Të hyrat jotatimore të planifikuara              |  |                                           |
| 50201 – Licenca Aktivitete Individuale të Lira   |  | 448,625.00€                               |
| 502016 – Licenca për Produkte Medicinale         |  | 820,182.37€                               |
| 50401 – shitje e shërbimeve                      |  | 16,165.50€                                |
| 50412 – Banderolla                               |  | 387,939.50€                               |
|                                                  |  |                                           |

# SHTOJCA I

## Plani i Performancës 2026

|                                                              |                                                                                                                                                                                                   |                                                |                                      |                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                   |                                                                                           |
|--------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|--------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------|
| Data:                                                        | 25.11.2025                                                                                                                                                                                        |                                                |                                      |                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                   |                                                                                           |
| AGJENCIA                                                     | Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale- AKPPM                                                                                                                                     |                                                |                                      |                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                   |                                                                                           |
| MINISTRIA PËRGJEGJËSE                                        | Ministria e Shëndetësisë- MSH                                                                                                                                                                     |                                                |                                      |                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                   |                                                                                           |
| Misioni i Agjencisë                                          | Mbrojtja e shëndetit publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës përmes garantimit të cilësisë, efikasitetit të produkteve dhe pajisje medicinale të plasuara në tregun e Republikës së Kosovës |                                                |                                      |                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                   |                                                                                           |
| Objektivat                                                   | Treguesi(t)                                                                                                                                                                                       | Vlera bazë                                     | e synuar                             | Rezultatet (outputet)                                                                           | Aktivitet kryesore                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | Alokimi financiar | Referenca ndaj dokumenteve strategjike/politike                                           |
| 1. Sigurimi i cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit të barnave | Numri i produkteve medicinale të regjistruar.                                                                                                                                                     | 2000 produkte të regjistruara                  | 2500 produkte të regjistruara        | Produkte të regjistruara cilësore dhe me dokumentacion sipas legjislacionit të BE-së dhe vendor | <ul style="list-style-type: none"><li>• Evaluimi i produkteve medicinale të aplikuara në Departamentin e Autorizim Marketingu.</li><li>• Marrja e rregullt e mostrave sipas programit të rregullt të mostrimit, Auditimi i praktikës së mirë të prodhimit të prodhuesëve të cilët janë të regjistruar në Republikën e</li></ul> | 300 000 euro      | Strategjia sektoriale Shëndetësore 2025-2030<br>Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale |
|                                                              | Nr i produkteve medicinale që nënshtrohen analizave.                                                                                                                                              | 10 numri i produkteve që nënshtrohen analizave | 15 analiza të kontrollit të cilësisë | Produkte medicinale të sigurta, cilësore për përdorim humane.                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                   |                                                                                           |
|                                                              | Numri i auditimit i praktikës së mirë të prodhimit të                                                                                                                                             | 6 auditime ne vende                            | 10 auditime ne vende të treta        |                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                   |                                                                                           |

|                                                                       | prodhuesë të cilët janë regjistruar në Republikën e Kosovës                                                       | të treta  |     |                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | Kosovës                                                                                                                |                                                                                        |  |
|-----------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|-----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|--|
|                                                                       |                                                                                                                   |           |     |                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | <ul style="list-style-type: none"><li>Trajnimi i stafit të AKPPM lidhur me proicedura te reja te EU</li><li></li></ul> |                                                                                        |  |
| 2.Zhvillimi i modulit për pajisje medicinale në sistemin e Barnatarit | Numri i informatave të grumbulluar lidhur me llojin e pajisjeve medicinale të vendosura në treg 5 vitet e fundit. | Në Proces | 30% | Platforme online për here të parë për identifikimin e të dhënave për pajisje te importuar në tregun e Republikes së Kosovës | <ul style="list-style-type: none"><li>Krijimi i modulit fillestar.</li><li>Testimi tremujor me qarkulluesit farmaceutik të sektorit.</li><li>Takime me operatorin ekonomik lidhur me mundësinë e inkuorimit të të dhënave në sistemin 'Barnatari';</li><li>Finalizimi i modulit;</li><li>Trajnimi i stafit</li><li>Trajnimi i paleve të interesit (qarkulluesve farmaceutik me shumicë) për përdorimin e modulit.</li></ul> | Donacion / 20,000.00                                                                                                   | Strategjia sektoriale Shëndetësore 2025-2030 Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale |  |
| 3. Raportimi i efekteve anësore dhe njoftimi i                        | - Numri i subjekteve                                                                                              | 10        | 15  | Informimi i publikut të gjerë lidhur me sigurinë                                                                            | <ul style="list-style-type: none"><li>Vlerësimi i raportimeve të</li></ul>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 10,000.00 euro                                                                                                         | Strategjia sektoriale Shëndetësore 2025-2030 te                                        |  |

|                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                         |     |      |                                                                                                                                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                                                    |
|---------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| profesionistëve shëndetësor, pacientëve dhe publikut të gjerë | farmaceutike dhe institucionet shëndetësore të njoftuara lidhur me efektet anësore të produktit medicinal.<br>-Numri i kërkesave të shqyrtuara për konfirmim për person lokal<br>10<br>përgjegjës për farmakovigjilencë<br>Nr i produkteve medicinale me efekte anësore | 500 | 1000 | dhe cilësisë së produkteve të regjistruara në Republikën e Kosovës                                                                                    | reaksioneve të dyshimta anësore vendore të raportuara nga profesionistët shëndetësor.<br>• Rekomandon tërheqjen nga tregu të produktit medicinal me efekte anësore<br>• Trajnimi i profesionisteve shëndetësorë<br>• Mban kontakte dhe kërkon raporte nga personat e autorizuar lokal për farmakovigjilencë të subjekteve farmaceutike që kanë produkte të regjistruara në AKPPM.<br>• Informimi dhe raportimi i efekteve anësore. | rubrika e zbraztë e qetë Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale                                                                 |
| 4. Transparenca dhe komunikimi me publikun                    | Numri i publikimeve në ueb-faqe.<br><br>Numri i njoftimeve për                                                                                                                                                                                                          | 20% | 80%  | Ngritja e besimit të publikut tek institucioni dhe përmirësimi i cilësisë së vendimmarrjes përmes një procesi më gjithëpërfshirës dhe illogaridhënës. | • Sigurimi i publikimit të rregullt dhe në kohë të dokumenteve thelbësore (p.sh., raportet financiare, buxhetet, planet e punës, planet e                                                                                                                                                                                                                                                                                          | Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave Themelore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës<br><br>Ligji Themelor për Transparençën: Ligji për |

| aktivitete të prokurimit të publikuara. | 10% | 80% | prokurimit, vendimet e marra) në ueb-faqen zyrtare dhe kanale të tjera.                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Qasjen në Dokumentet Publike |
|-----------------------------------------|-----|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------|
|                                         |     |     | <ul style="list-style-type: none"> <li>Përgjigjja efektive dhe në afat ligjor ndaj kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumente publike.</li> <li>Mirëmbajtja e ueb-faqes zyrtare dhe platformave të tjera dixhitale me informacione të sakta dhe të përditësuara rregullisht për aktivitetet dhe shërbimet.</li> <li>Platforma te reja online</li> </ul> |                              |

Arian Ahmeti

Drejtori i Agjencisë

Zana Haraqia

Njësia Përgjegjëse